



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

Prishtinë, më 21 dhjetor 2020

Z. Fehmi Mehmeti, Guvernator
Banka Qendrore e Kosovës

LETËR REKOMANDIMI

Ankesa nr. 334/2020
kundër
Bankës Qendrore të Kosovës

I nderuari z. Mehmeti,

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit dhe në bazë të nenit 21 të Ligjit nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, më 2 qershor 2020, ka pranuar ankesë nga z. Besnik Krasniqi, gazetar në gazetën “Koha Ditore”, parashtruar kundër Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), për qasje të kufizuar në dokumente publike.

Në bazë të informatave që ka në dispozicion Avokati i Popullit dhe pohimeve të ankuesit, më 9 dhjetor 2019, ai iu ka drejtuar BQK-së me kërkesë për qasje në: “*Vendimet e Bankës Qendrore të Kosovës për miratim të auditorit të jashtëm për këto dy kategori institucionesh: Siguruesve, ndërmjetësuesve të sigurimeve, trajtuesve të dëmeve dhe Byrosë Kosovare të Sigurimeve; si dhe Bankave; institucioneve financiare jobankare dhe institucioneve mikrofinanciare.*” Si përgjigje në kërkesën e tij, ankuesi ka marrë nga BQK-ja vetëm disa të dhëna, por jo dokumentet e kërkuara. Më 25 shkurt 2020, gazeta “Koha Ditore” iu ka drejtuar përsëri BQK-së lidhur me dokumentet e kërkuara, megjithatë nuk ka marrë përgjigje.

Më 16 qershor 2020, Avokati i Popullit iu ka drejtuar me shkresë BQK-së, me ç’ rast ka kërkuar informata lidhur me veprimet që BQK-ja i ka ndërmarrë dhe/ose veprimeve që planifikonte t’i ndërmerre përkitazi me kërkesën e ankuesit për qasje në dokumentet e kërkuara, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Më 1 korrik 2020, Avokati i Popullit ka marrë një përgjigje nga BQK-ja, me të cilën është njoftuar se BQK-ja i ka lejuar qasje ankuesit në listën me të gjithë emrat e auditorëve të jashtëm, e miratuar nga BQK-ja, për sigurues, ndërmjetësues në sigurime, trajtues të dëmeve, Byrosë Kosovare të Sigurimeve (BSK), banka dhe institucione financiare. Po ashtu ka njoftuar se këto të dhëna janë publike dhe mund të gjenden në raportet vjetore të të gjitha institucioneve financiare ku publikohet raporti i auditorit të jashtëm. Ndërsa, sa u përket vendimeve të BQK-së për miratim të auditorit të jashtëm për këto kategori institucionesh, si:

siguruesve, ndërmjetësuesve të sigurimeve, trajtuesve të dëmeve dhe BSK-së; si dhe bankave, institucioneve financiare jobankare dhe institucioneve mikrofinanciare, në përgjigje thuhej se janë dokumente konfidenciale bazuar në nenin 74 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Ligji për BQK-në). Më tej, BQK-ja rikujton se Ligji për BQK është ligj special që i përcakton përgjegjësitë dhe detyrat e BQK-së.

Më 4 shtator 2020, Avokati i Popullit iu ka drejtuar përsëri me shkresë BQK-së dhe i ka kërkuar informata për nivelin e klasifikimit të dokumenteve të kërkuara nga ankuesi, sipas Ligjit nr. 03/L-178 për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë. Më 25 shtator 2020, Avokati i Popullit ka marrë përgjigje nga BQK-ja, e cila, ndër të tjera, i referohet Ligjit për BQK-së dhe dispozitave të këtij ligji për ruajtjen e konfidencialitetit (neni 74) në lidhje me informacionet jopublike të BQK-së (neni 74, paragrafi 1, paragrafi 2 dhe nënparagrafi 2.1), Rregullës së Brendshme mbi Fshehtësinë, si dhe nenit 2 të Ligjit nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, dhe me të cilën nxirret përfundimi se informacionet e kërkuara nga ankuesi janë konfidenciale.

Avokati i Popullit rikujton se kërkesat për qasje në dokumente publike që u drejtohen institucioneve publike nga qytetarë, nga shoqëria civile, nga media etj., janë kërkesa të cilat parashtrohen duke u nisur nga garancitë kushtetuese e ligjore në vend. Kushtetuta, në nenin 41, paragrafi 1, përcakton: *“Secili person gëzon të drejtën e qasjes në dokumente publike.”*; dhe në paragrafin 2 përcakton: *“Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë.”*

Ndërsa Ligji nr. 06/L-81 për Qasje në Dokumente Publike (LQDP), në nenin 1, e përcjellë frymën e nenit 41 të Kushtetutës, sipas të cilit: *“Ky ligj garanton të drejtën e secilit person, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje në dokumente publike, të prodhuara, pranuar, mbajtura apo kontrolluara nga institucionet publike, si dhe të drejtën për ripërdorimin e dokumenteve të sektorit publik.”*

E drejta për t’u informuar është e drejtë e garantuar me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, neni 19 i së cilës përcakton: *“Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit pa ndërhyrje, si dhe lirinë e kërkimit, marrjes dhe përhapjes së informacionit dhe ideve me çfarëdo mjetesh, pa marrë parasysh kufijtë.”*

Lirinë për të marrë dhe për të dhënë informacion e parasheh edhe neni 10, paragrafi 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) - [Liria e Shprehjes]: *“Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë...”*

Trajtimi i kërkesave për qasje në dokumente publike është detyrim ligjor për të gjitha subjektet që ushtrojnë autorizime publike. Rrjedhimisht, kërkesat për qasje në dokumente publike, të parashtruara në institucione që ushtrojnë autorizime publike, nuk mund të trajtohen ndryshe përveçse sipas dispozitave ligjore në fuqi e që hyjnë në fushën e punëve të

përditshme të administratës publike e shtetërore. Për më tepër, kërkesa e ankuesit për qasje në dokumente publike ka të bëjë me dokumente të cilat janë në interes të publikut të gjerë dhe duhet të jenë dokumente/informata të qasshme, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi. Dokumentet e kërkuara nga ankuesi janë vendime për miratimin e auditorëve të jashtëm, pra janë dokumente procedurale që kanë të bëjnë me veprimet procedurale të BQK-së.

Për më tepër, BQK-ja ia ka shpalosur ankuesit listën e plotë me të gjithë emrat e auditorëve të jashtëm të miratuar për sigurues, ndërmjetësues në sigurime, trajtues të dëmeve, BKS-së, banka dhe institucione. Konstatimi i BQK-së se vendimet me të cilat janë miratuar këto kategori institucionesh janë konfidenciale nuk mbështetet në dispozitat ligjore të cilat përcaktojnë mënyrën dhe nivelin e klasifikimit.

Avokati i Popullit e thekson se BQK-ja nuk ka ofruar informacion sa i përket nivelit të klasifikimit të dokumenteve sipas Ligjit nr. 03/L-178 për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë. Mosklasifikimi i dokumenteve sipas dispozitave ligjore të përcaktuara me Ligjin nr. 03/L-178 për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë i hap rrugë arbitraritetit në vendosje për lejim apo refuzim të qasjes në dokumente publike. E drejta për qasje në dokumente publike është e drejtë e garantuar me Kushtetutë, ndërkaq kufizimi duhet të jetë përjashtim.

Avokati i Popullit vlerëson se përjashtimet e së drejtës për qasje në dokumente janë të përcaktuara me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike, përderisa informacionet mund të kufizohen vetëm për qëllime të mbrojtjes së interesave legjitime publike, të jetës ose të interesave të tjera legjitime private, të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

E drejta për qasje në dokumente publike e secilit person si dhe garantimi dhe përmbushja e kësaj të drejte nga ana e institucioneve publike përbën një prej themeleve të institucioneve demokratike dhe transparente. Hapja e të dhënave dhe transparenca në sektorin publik shërben për llogaridhënie ndaj publikut, për zhvillimin dhe avancimin shoqëror, ekonomik dhe demokratik.

Avokati i Popullit konstaton se, në rastin në fjalë, BQK-ja ka dështuar në përmbushjen e detyrimeve lidhur me mundësimin, përkatësisht lejimin për qasje në dokumente publike në përputhje me kërkesën e parashtruar të ankuesit, e cila është e drejtë e garantuar me akte vendore dhe me instrumente ndërkombëtare

Me qëllim të përmirësimit të respektimit të së drejtës për qasje në dokumente publike, si e drejtë kushtetuese dhe ligjore, në mënyrë që qytetarët ta shfrytëzojnë këtë të drejtë, si mjet të fuqishëm për kontrollin e punës së organeve të pushtetit, e që do të ndikonte në përmirësimin e punës së organeve shtetërore dhe rritjen e transparencës dhe të llogaridhënies, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i


REKOMANDON

Bankës Qendrore të Kosovës:

- *Ta trajtojë kërkesën e ankuesit dhe t'i ofrojë qasje në dokumentet e kërkuara, në pajtim me Ligjin nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike dhe në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.*

- *Të vendosë përkitazi me klasifikimin ose jo të informacioneve/dokumenteve, qysh në momentin kur i prodhon ato, sipas detyrimeve nga Ligji nr. 03/L-178 për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë.*
- *Ta krijojë listën e dokumenteve/informacioneve tashmë të prodhuara, sipas kritereve të klasifikimit dhe specifikimeve të tjera me Ligjin nr. 03/L-178 për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, (...) duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi të na informoni për veprimet që do t’i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Naïm Qelaj
Avokat i Popullit